



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.459/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje LVV, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET E BAZUAR ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës PDK, me seli në Komuna Prishtinë, Anr.459/2025 datë 07.02.2025.

II. Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 1,500.00€uro (njëmijepesëqind) €uro.

III. Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

IV Urdhërohet kandidati i subjektit politik LVV Besim Muzaqi, që nga momenti i marrjes së këtij vendimi ta largoj nga rrjeti social facebook postimin me titull "*Pediatria në spitalin e Mitrovicës 83-shi CEP MË CEP*".

A r s y e t i m

Me datë 07.02.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik më datë 22 janar 2025, kandidati për deputet nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, z, Besim Muzaqi, ka publikuar një video në rrjetin social Facebook, në ambientet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, me qëllim të përfitimit të votave. Konkretisht, i njëjti këtë video e cila është realizuar në sallën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, përgjatë fjalimit të mbajtur në një nga seancat plenare të Kuvendit të Kosovës, e ka publikuar me tekst përshkruar "*Pediatria në spitalin e Mitrovicës 83-shi CEP MË CEP*"

Më tej theksohet se PZAP-i me Vendimin A.Nr.145/2025, të datës 26.01.2025, ka shpallur përgjegjës Subjektin Politik LVV për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët dhe i ka shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej 6,000.00€ dhe pas plotfuqishmërisë së këtij Vendimi, postimi Vazhdon të jetë aktiv në profilin e z. Besim Muzaqi.

Provë: Linku i postimi në rrjetin social Facebook <https://www.facebook.com/reel/500276346000244>;

Në përgjigjen në ankesë të datës 09.02.2025, theksohet se konsiderojnë se sanksioni i dhënë nuk mund të përsëritet për shkak se z. Besim Muzaqi nuk ka përsëritur shkeljen dhe për të njëjtën njëherë është dënuar (res judicata). Arsytimi se shkelja vazhdon të prodhojë efekt nuk mund të jetë bazë për një dënim të përsëritur sepse kjo do të cenonte sigurinë juridike dhe do të zbehte rolin e procedurës e cila ka nxjerre njëherë vendim. Ndërsa është e pavërtetë citimi i rasteve analoge nga parashtruesi i ankesës pasi që në pikën 6 dhe 7 të ankesës referohet në një rast që fare nuk ka ndonjë ngjashmëri me objektin e kësaj anese, pasi që nuk flitet për përsëritje të dënimit ashtu siç ankuesi pretendon rasti A.nr.347/35 i kandidatit Z. Dimal Basha ku PZAP ka urdhëruar fshirjen e postimit bashkangjitur me dënimin e parë, ndërsa z. Besim Muzaqi nuk është detyruara nga PZAP të bëjë një gjë të tillë por vetëm është dënuar njëherë (res judicata). Konsiderojmë se referimi në këto raste ka për qëllim të ngrit paralele të gabuara mes rasteve sepse nuk është e vërtetë se z. Dimal Basha për të njëjtin objekt është dënuar dy herë, mirëpo ai është detyruar nga PZAP të fshij.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën, përgjigjen në ankesë, vëren se ankesa është bazuar.

-Ankesa është e bazuar.

Paneli me vendimin e tij Anr 145/2025 të datës 26.01.2025 e ka Pranuar të bazuar ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës PDK, me seli në Komuna Prishtinë, ndërsa subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i ka shqiptuar dënimin më gjobë në lartësi prej 6,000.00 (gjashtëmijë) Euro, dhe e ka detyruar të njëjtën që gjobën e shqiptuar ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

Ndaj vendimit të PZAP-it subjekti politik LVV ka parashtruar ankesë në Gjykatën Supreme dhe e njëjta me Aktgjykimin AA 17/2025 të datës 01.02.2025 ankesën e subjektit politik LVV e ka refuzuar të pabazuar dhe ka vërtetuar vendimin e PZAP-it.

Në ankesën e Anr. 459/2025 të datës 07.02.2025 subjekti politik PDK thekson se kandidati për deputet nga subjekti politik LVV Besim Muzaqi nuk e ka fshirë ende postimin dhe po vijon me shkeljen përsëritëse në të cilin postim shprehimisht thotë se “Pediatria në spitalin e Mitrovicës 83-shi CEP MË CEP”, ku krahas këtij postimi ka bashkangjitur një foto të kryeministrit Albin Kurti që vjen nga radhët e subjektit politik LVV.

Paneli, pas shikimit të bërë videos si provë materiale e cila është publikuar në rrjetin social të kandidatit për deputet të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) Besim Muzaqi, si dhe hetimet e bëra nga Paneli, është vërtetuar se postimi i videos ende ekziston në rrjetin social të kandidatit Besim Muzaqi, prej nga rrjedh se ky postim ka për qëllim promovimin e subjektit politik LVV. Sipas panelit videoja është bërë me qëllim të përfitimit të votave dhe se ende është aktive, veprim ky i cili bie në kundërshtim me dispozitën e nenit 36 par.1, Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës parashihet se *“Personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë at zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave.....”*.

Paneli vlerëson se në rastin konkret kandidati, përkatësisht subjekti politik LVV përkundër vendimit të formës së prerë të PZAP-it A.nr.145/2025, datë 26.01.2025, nuk i është përmbajtur detyrimin që të largoj postimin nga rrjeti social facebook, andaj bazuar në këtë vendim të PZAPI-it, urdhërohet kandidati nga subjekti politik LVV Besim Muzaqi që nga momenti i marrjes së këtij vendimi ta largoj postimin e publikuar nga rrjeti social facebook. Njëherit njoftohet subjekti politikë në fjalë se duhet të veprojnë sipas nenit 120, par.2 të LZP, ndërsa dështimi për t'iu bindur kësaj urdhëresë të PZAP-it, brenda periudhës së përmendur në vendim, paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nen parafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Anr.459/2025, datë 10.02.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së.